

Datë: 24/11/2025

TERMA REFERENCE

Subjekti	Ledio Fejzaj PF
Objekti i prokurimit:	Frontend Developer
Buxheti maksimal (lekë, me TVSH):	1,500,000 lekë
Data e nisjes së prokurimit:	24/11/2025
Data e mbylljes së prokurimit:	02/12/2025

1. Përmbledhje

Ky dokument përcakton termat e referencës për kontraktimin e një shërbimi në kuadër të projektit "**Zhvillimi i aplikacionit Onemor**", i cili zbatohet nga **Ledio Fejzaj PF** në kuadër të programit **NOMAD TECH** në partneritet me **Shoqatën LIBURNETIK**.

Kompania synon **të zhvillojë një platforme online (aplikacion)**, e cila synon të mundesoj nga njera ane, një platforme për trajneret që dëshirojnë të promovojnë/shesin programet e tyre stervitore dhe nga ana tjetër një hapësirë digjitale ku përdoruesit mund të blejnë programet stervitore nga trajneret e tyre të preferuar.

Nëpërmjet këtij projekti, përfituesi do të angazhojë një Ekspert për të realizuar shërbimi e **Frontend Developer**.

2. Qëllimi i Kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është angazhimi i një Eksperti për të realizuar shërbimin e **Frontend Developer**.

Eksperti do të realizojë detyrat e mëposhtme:

Zhvillim dhe mirëmbajtje e arkitekturës së frontend-it duke përdorur framework-e moderne (React preferred).

Konvertim i dizajneve UI/UX dhe wireframes në ndërfaqe funksionale, responsive dhe të optimizuara.

Integrim me API-t backend dhe siguri për rrjedhë të qartë të të dhënave.

Optimizim i performancës së aplikacionit për shpejtësi, aksesueshmëri dhe kompatibilitet ndër-browse.

Shkrim i kodit të pastër, të mirëstrukturuar dhe të ripërdorshëm, sipas standardeve më të mira.

Testim, debugging dhe zgjidhje problemesh teknike.

Pjesëmarrje në takime javore, raportime progresi dhe diskutime teknike me ekipin.

Dokumentim i komponentëve, proceseve dhe varësive të aplikacionit.
Identifikim i bottleneck-ve dhe sugjerim përmirësimesh teknike.

4. Kohëzgjatja e Kontratës

Kontrata do të **deri në 30 Janar 2026**, duke filluar nga **data e nënshkrimit, 5 ditë nga mbyllja e afatit të dorëzimit të ofertave**.

Çdo ndryshim në afatet ose përmbajtjen e produktit do të diskutohet paraprakisht me Subjektin Kontraktues dhe do të reflektohet me dakordësi të dyanshme.

5. Dorëzimet e pritura gjatë kontratës:

Ndërfaqe frontend plotësisht funksionale sipas dizajneve UI/UX.
Komponentë të dokumentuar, modularë dhe të ripërdorshëm.
Integrim i suksesshëm me API backend.
Testime funksionale dhe raport i çështjeve të adresuara.
Build final i aplikacionit gati për QA dhe UAT.

Kriteret Teknike

Eksperiencë e dokumentuar si Frontend Developer.
Njohje e thellë e HTML5, CSS3/SCSS/SASS, JavaScript (ES6+).
Eksperiencë me React.js (ose Vue/Angular).
Përdorim i REST APIs dhe struktura JSON.
Njohuri të versionimit me Git dhe zhvillimit të bazuar në komponentë.
Punë me Figma/XD dhe dizajne mobile-first.
Përvoja me TypeScript, Next.js, Redux/Zustand (preferohet).
Njohuri mbi CI/CD, Docker ose mjedise cloud.
Kuptim i parimeve të aksesueshmërisë dhe SEO për UI.

Kriteret Financiare

- Oferta financiare do të vlerësohet sipas raportit cilësi/çmim, ku:
 - o 30% peshë për kriteret teknike
 - o 70% peshë për çmimin më të ulët të pranueshëm

7. Vlera e Kontratës dhe Pagesat

- Fondi limit: **1,500,000 (me TVSH)**.
- Pagesa do të kryhet në **1 këst**, pas përfundimit të shërbimit.
- Në rast se fituesi është individ pa NIPT, do të aplikohet tatimi mbi të ardhurat (15%) sipas legjislacionit në fuqi.

8. Dorëzimi i Ofertave

Subjektet e interesuara për të marrë pjesë në këtë procedurë duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues:

8.1 Për subjekt fizik/juridik

- Ekstrakt nga QKB
- CV
- Vertetim qe ska detyrime

8.2 Për individë (ekspertë të pavarur)

- CV e detajuar ku të evidentohet eksperiencia përfshirë arsimimin, eksperiencën profesionale, projektet e mëparshme dhe certifikimet përkatëse.
- Diploma universitare (nese e disponon)
- Portofol punimesh (link ose dokument me projekte të realizuara) (nese e disponon)

8.3 Dokumente Financiare

- Oferta financiare duke specifikuar shërbimin e mësipërm e firmosur dhe vulosur.

8.4 Afati dhe mënyra e dorëzimit

- Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen **brenda datës 02/12/2025**
- Dokumentet duhet të dorëzohet me email në adresën: info@onemor.com
- Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit të përcaktuar nuk do të merret në shqyrtim.

9. Kriteret e skualifikimit

Subjekti do të skualifikohet nëse:

- Nuk dorëzon dokumentacionin e plotë;
- Nuk përmbush kushtet ligjore/financiare;
- Ka dhënë informacion të pasaktë;
- Nuk dëshmon eksperiencën e kërkuar

Nenshkrimi

Alban Fazëaj


Datë:24/11/2025

FTESË PËR OFERTË

Subjekti	Ledio Fejzaj PF
Objekti i prokurimit:	Frontend Developer
Buxheti maksimal (lekë, me TVSH):	1,500,000 lekë
Data e nisjes së prokurimit:	24/11/2025
Data e mbylljes së prokurimit:	02/12/2025

Ledio Fejzaj PF, në kuadër të programit NOMAD TECH – Fuqizimi i Gjeneratës së Ardhsme të Novatorëve, zbatuar nga Shoqata LIBURNETIK, në mbështetje të start-upeve dhe të rinjve novatorë në Shqipëri, pjesë e një nisme për zhvillimin e ekosistemit të teknologjisë së lartë dhe ekonomisë dixhitale në vend, shpall ftesën për ofertë për kontraktimin e shërbimit të : **Frontend Developer**.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri në datën **02/12/2025**, në adresën e emailit: info@onemor.com.

Specifikimet teknike:

Eksperti do të ofrojë shërbime sipas detyrave të mëposhtme:

- Zhvillim i ndërfaqes së përdoruesit duke përdorur framework modern (React i preferuar), me komponentë të ripërdorshëm dhe arkitekturë të strukturuar.
- Konvertim i dizajneve UI/UX (wireframes, prototipe, layouts) në ekrane plotësisht funksionale dhe responsive për web/mobile.
- Integrim i frontend-it me API-t backend duke siguruar rrjedhë të qartë dhe të sigurt të të dhënave.
- Optimizim i performancës së aplikacionit për shpejtësi, aksesueshmëri dhe kompatibilitet ndër-browse.
- Zbatim i standardeve më të mira të kodimit, duke prodhuar kod të pastër, të dokumentuar dhe të mirë-organizuar.
- Implementim i logjikës së state management (Redux, Zustand ose të ngjashme).
- Zbatim i praktikave të debugging, testimit dhe sigurimit të cilësisë së komponentëve.
- Përdorim i TypeScript dhe Next.js (nëse kërkohet nga projekti).
- Përdorim i Git për versionim dhe bashkëpunim në mjedise Agile/Scrum.

- Pjesëmarrje në takime teknike, raportim progresi dhe propozim zgjidhjesh për përmirësim të performancës dhe arkitekturës së aplikacionit.

Kushte të përgjithshme:

Dorëzimi i ofertave do të bëhet vetëm me email.

Pagesa do të kryhet me transfertë bankare pas përfundimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës.

Dorëzimet e pritura gjatë kontratës:

Ndërfaqe frontend plotësisht funksionale sipas dizajneve UI/UX.

Komponentë të dokumentuar, modularë dhe të ripërdorshëm.

Integrim i suksesshëm me API backend.

Testime funksionale dhe raport i çështjeve të adresuara.

Build final i aplikacionit gati për QA dhe UAT.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesin të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- Ekstrakt nga QKB (për subjekte juridike) ose dokument identifikimi (për individë).
- CV
- Ofertë financiare në ALL me TVSH të përfshirë.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

Nënshkrimi

Alban Fazëaj

